



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 55/5 Prot

Tiranë, më 02.06.2021

V E N D I M

Nr.63, datë 02.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit, në Bashkinë Kavajë, filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 55 prot., datë 13.1.2021, paraqitur prej nëpunësit civil ***.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90/1, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 55 prot., datë 13.1.2021, nëpunësi ***** ka parashtruar pretendimin se, transferimi i tij për shkak të ristrukturimit të institucionit në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Planifikimit të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit”, në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit, pranë Bashkisë Kavajë, është i padrejtë pasi, së pari, pozicioni i tij i punës nuk ka ndryshuar, por thjesht ka ndryshuar emërtesa, nga “Drejtor” në “Përgjegjës Sektori”, duke ulur edhe kategorinë e pagës nga II-b në III-b; së dyti, ai mund dhe duhet të sistemohet në një pozicion pune “Drejtor”, pasi sipas strukturës së re, ekzistojnë pozicione të lira të kësaj kategorie.

Në kuadër të verifikimit të këtyre pretendimeve, u kërkua dokumentacioni përkatës në Bashkinë Kavajë, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi e vërtetuar sa më poshtë:

Nëpunësi ***** është nëpunës civil, i cili ka kryer detyrën, “Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Menaxhimit të Borxhit”, pranë Bashkisë Kavajë, i emëruar me aktin nr. 575/1, datë 17.2.2017, pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit.

Në këtë pozicion, ka vazhduar pa ndërprerje deri në momentin që, pas miratimit të strukturës së re, me Vendimin nr.1, datë 5.1.2021, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kavajë për vitin 2021”, institucioni është futur në proces ristrukturimi, për shkak të shtimit të numrit të punonjësve dhe ndryshimeve në organizimin e njësive, i cili duhet të kryhej sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse.

Në rastin konkret, sipas strukturës së mëparshme, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 6.1.2020, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kavajë për vitin 2020”, Drejtoria e të Ardhurave dhe Menaxhimit të Borxhit, ku nëpunësi ***** mbante pozicionin “Drejtor”, ishte e organizuar si drejtori më vete, e përbërë vetëm nga “Sektori i Planifikimit të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit” (1 Përgjegjës Sektori dhe 2 Specialistë).

Me strukturën e re të miratuar, konstatohet që, Drejtoria e të Ardhurave dhe Menaxhimit të Borxhit, është riorganizuar në nivel sektori, duke u përfshirë në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit, me emërtesën “Sektori i Planifikimit të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit”, ku nëpunësi ***** është transferuar në pozicionin “Përgjegjës Sektori” (1 Përgjegjës Sektori dhe 3 Specialistë).

Nga këqyrja e akteve konstatohet se, e njëjta situatë ka ndodhur edhe me Drejtorinë e Projektimit, Politikave Zhvillimore dhe Investimeve të Huaja, e cila me strukturën e re, është riorganizuar në nivel sektori. Këto ndryshime, që kanë sjellë rikonceptimin e drejtorive apo edhe shtimin e numrit të punonjësve (nga 603 punonjës në 605, që i përkasin nëpunësisë civile), tregojnë se institucioni ishte në kushtet e riorganizimit dhe janë arsye që diktojnë kryerjen e procesit të ristrukturimit, në bazë të rregullave të legjislacionit të shërbimit civil dhe shërben për riorganizimin e institucionit pas shkurtimit apo shtimit të vendeve të punës, sikurse ka ndodhur në rastin konkret.

Procesi i ristrukturimit, është realizuar në përmbushje të kërkesave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të

Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

Nga përmbajtja e dispozitave ligjore si më sipër, rezulton se, njësia përgjegjëse ka për detyrë të drejtojë gjithë procesin e ristrukturimit nga ana ligjore, duke vepruar, *së pari*, me njoftimin individualisht të nëpunësve për fillimin e procesit të ristrukturimit dhe nisjen e procedurave për zhvillimin e procesit; *së dyti*, me nxjerrjen e aktit të krijimit dhe të funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit, i cili nga ana e tij ka për detyrë të shqyrtojë mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe të bëjë propozimin përkatës për transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike dhe *së treti*, ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit.

Në rastin e Bashkisë Kavajë, nga përmbajtja e akteve të dërguara nga ana e institucionit, nëpërmjet shkresës nr.254/1, datë 26.1.2021, “Dërgim informacioni në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit” (në përgjigje të shkresës nr.55/2, datë 19.1.2021, të Komisionerit), rezulton se, njësia e burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, nuk i ka zbatuar detyrimet ligjore që përcakton ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore, duke mos respektuar asnjë element të procedurës që shoqëron procesin e ristrukturimit.

Në këtë përfundim arrihet duke analizuar edhe rastin konkret, pasi ndodhemi përpara faktit kur, nga njëra anë, për shkak të ristrukturimit, Drejtoria e të Ardhurave dhe Menaxhimit të Borxhit, ku nëpunësi në fjalë mbante pozicionin “Drejtor”, është riorganizuar dhe rikonceptuar në nivel sektori dhe nga ana tjetër, transferimi i tij në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit”, është bërë në kundërshtim me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, në kushtet kur konstatohet se institucioni, në kryerjen e këtij procesi administrativ, është mjaftuar vetëm me vendimin e marrë nga titullari i institucionit nëpërmjet një urdhëri transferimi, të motivuar nga riorganizimi i drejtorisë si pasojë e ristrukturimit (Urdhër “Për transferim” nr.13, datë 5.1.2021, i Kryetarit të Bashkisë).

Në kushtet e një ristrukturimi të rregullt, duke analizuar gjendjen e fakteve si më sipër, bazuar në pikën 1, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se, nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion

tjetër të shërbimit civil *të së njëjtës kategori*, nëpunësi në fjalë, mund të transferohej për këtë shkak, në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues. Nëse në strukturën e re të insitucionit të Bashkisë Kavajë, nuk ka pozicion të lirë të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues dhe nëpunësi nuk pranon transferimin në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, pra, të një kategorie më të ulët, atëherë Komisioni i Ristrukturimit, propozon përfundimin e marrëdhënies së tij në shërbimin civil, përmes lirit nga shërbimi civil në përputhje me pikën 1, shkronja “a”, e nenit 66, të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në vijim të arsytimit, në mbështetje të nenit 50, pika 7, e ligjit 152/2013, i ndryshuar, nëse nëpunësi largohet nga pozicioni i tij i punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në shërbimin civil, sipas rasteve të parashikuar në këtë dispozitë, duke ruajtur statusin e nëpunësit civil, kategoria e mesme drejtuese në shërbimin civil, dhe pika 8 e tij, parashikon që brenda një periudhe 2-vjeçare, nëpunësi ruan të drejtën:

- a) *të konkurrojnë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;*
- b) *të emërohet në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tij, në pozicione të shërbimit civil.*

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në konkluzionin se, mosrespektimi i dispozitave ligjore të sipërcituara, bën që Urdhëri nr. 13, datë 5.1.2021, “*Për transferim*”, i nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë, për transferimin e përhershëm për shkak të ristrukturimit të nëpunësit ***** bazuar në shkronjën “i”, të pikës “a”, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të jetë një akt absolutisht i pavlefshëm dhe si i tillë, në bazë të neneve 110 pika 1, 113 dhe 114, pika 1, të këtij ligji, duhet të anulohet me një akt të ri me shkrim, i cili ti japë zgjidhje ligjore mosmarrëveshjes së lindur, duke zbatuar rregullat e ristrukturimit të cituara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkohet nga organi publik, Kryetari i Bashkisë Kavajë, që me një akt të ri me shkrim, të anulojë aktin administrativ nr. 13 (nr.14 Prot.), datë 5.1.2021, *“Për transferim”*, për transferimin e përhershëm të nëpunësit *****, për shkak të ristrukturimit, në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit”*, si një akt i paligjshëm, duke vepruar në këtë mënyrë edhe në raste të ngjashme.
2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të krijojë Komisionin e Ristrukturimit, i cili duhet të marrë në shqyrtim e të bëjë vlerësimin përkatës për mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil, në rastet kur pozicioni i punës është suprimuar ose riorganizuar, në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike.
3. Vendimi përfundimtar i riemërimit/transferimit pas ristrukturimit, do të merret nga njësia e burimeve njerëzore, e cila ka edhe detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirim nga shërbimi civil për ata nëpunës, të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës apo që u është ristrukturuar për shkak të ndryshimit të përshkrimit dhe kërkesave të përgjithshme e të veçanta të vendit të punës.
4. Në rastin e punonjësit *****, njësia e burimeve njerëzore, pas kryerjes së procedurave të ristrukturimit, të nxjerrë një akt të ri me shkrim, duke vepruar në këtë mënyrë:
 - Të vlerësojë mundësinë e sistemimit të tij, në një pozicion pune të kategorisë së mesme drejtuese, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike të vendit të punës, duke ruajtur në këtë mënyrë nivelin e kategorisë që i përkiste pozicionit të tij të mëparshëm;
 - Nëse ky sistemim nuk është i mundur, të ofrojë mundësinë e transferimit të tij në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit”*, duke marrë pëlqimin e tij me shkrim, sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu II, të Vendimit nr.125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*;
 - Në rast refuzimi të pajustificuar të këtij pozicioni, sipas pikës 21, të aktit nënligjor, kjo përbën shkak për lirim nga shërbimi civil, duke respektuar në këtë rast, të drejtat që parashikon pika 7, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, ndër të cilat përfshihet e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë; e drejta për

të konkurruar për një periudhë 2 vjeçare në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe e drejta për t'u emëruar në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tij, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil. Kjo dispozitë, duhet të respektohet për të gjithë punonjësit, të cilët do të lirohen apo janë liruar për shkak të ristrukturimit.

5. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **20** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore të institucionit është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e përcaktuara në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Kavajë dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha